



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Programin për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2017 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 192/2016), Ministria e Ekonomisë shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për subvencionimin e ndërmarrjeve për zbatim dhe çertifikim të HALLALL sistemit

1. Lëndë e thirrjes publike është subvencionimi i ndërmarrjeve për zbatim dhe çertifikim të HALLALL sistemit, përmes kofinansimit të 70% të shpenzimeve të dëshmuara për këtë qëllim, por jo më shumë se 200.000 denarë veçmas për secilin subjekt afarist-kërkues të mjeteve.

Në pajtim me Programin për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2017 pjesa II, A. Përkrahja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, masa 5 – Përkrahje financiare për zbatim dhe çertifikim të HALLALL sistemit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr 192/2016) janë të parapara mjete në vlerë të përgjithshme prej 1.400.000 denarë.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë të gjitha ndërmarrjet aktive të cilat i plotësojnë këto kushte:

- Punë prej më së paku gjashtë muaj para shpalljes së thirrjes publike (*regjistrimi në regjistrin tregtar*);
- Të kenë seli afariste në teritorin e Republikës së Maqedonisë;
- Të kenë të shlyera obligimet ndaj shtetit dhe të punësuarve.

Këto subvencione **nuk janë të dedikuara** për :

- Ndërmarrjet ndaj të cilave është ngritur procedura e falimentimit apo e likuidimit.
- Ndërmarrjet të cilët kanë qenë të subvencionuara për zbatim dhe çertifikim të HALAL sistemit në vitin 2015 dhe 2016.

Në rast se ndërmarrja e cila aplikon për kofinansim të shpenzimeve në bazë të kësaj mase ndërpret ushtrimin e veprimtarisë para skadimit të një viti nga data e marrjes së mjeteve (përveç në rast të vdekjes ose paaftësisë së përhershme), në atë rast themelusi i firmës ka obligim të kthen 80% prej mjeteve financiare të ndara në bazë të qëllimeve të parapara në periudhë prej 12 muajve.

Pas skadimit të një viti nga data e marrjes së mjeteve Ministria e ekonomisë nëpërmjet Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë do të kontrollojë nëse ndërmarrja e cila ka qenë e subvencionuar në vitin 2017 është ende aktive. Në rast se vërtetohet se ndërmarrja ka ndërprerë me kryerjen e veprimtarisë, Ministria e ekonomisë do të inicon procedurë për kthyerje të mjeteve.

3. Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Formulari i plotësuar „ **Kërkesë –HALLALL 2017** “ (mund të meret nga arkiva ose ueb faqja e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk);
- Formulari i plotësuar „ **Deklaratë – 2017** “ , e vërtetuar te noteri ((Deklarata nga kërkuesi për ndarjen e ndihmës shtetërore mund të meret nga arkiva ose ueb faqja e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk);
- Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;
- Vërtetim për tatime dhe kontribute të paguara nga Drejtoria për të Hyra Publike e Republikës së Maqedonisë, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;

- Marrëveshje për zbatim të HALLALL sistemit ndërmjet kërkuesit dhe konsulentit të autorizuar/shtëpia konsulente e lidhur gjatë vitit 2016 ose 2017 (data e Marrëveshjes të jetë para datës së Çertifikatës së lëshuar), e vërtetuar te noteri;
- Marrëveshje për çertifikim të HALLALL sistemit ndërmjet kërkuesit dhe Agjensionit për HALLALL standard në Maqedoni, e lidhur gjatë vitit 2016 ose 2017 (data e Marrëveshjes të jetë para datës së Çertifikatës së lëshuar), e vërtetuar te noteri;
- Çertifikatë për HALLALL sistem nga Agjensioni për HALLALL standard në Maqedoni, lëshuar gjatë vitit 2016 ose 2017;
- Faturë për shpenzimet e realizuara për zbatim të HALLALL sistemit nga konsulenti i autorizuar/shtëpia konsulente;
- Faturë për shpenzimet e realizuara për çertifikim të HALLALL sistemit nga Agjensionit për HALLALL standard në Maqedoni;
- Çertifikatë nga banka në të cilin shihet që aplikuesi në tërësi i ka shlyer detyrimet për shpenzimet e realizuara nga faturat e dorëzuara;
- Fletpagesë në vlerë prej 250,00 denarë (Qëllimi i pagesës: Pagesë për taksa administrative, Emërtimi dhe selia e pranuesit: Të ardhura të organeve të drejtorisë, Banka e pranuesit: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, Llogaria Trezore:100000000063095, Llogaria: 840 ___ (në varësi të komunës) 06116, Kodin e të ardhurave dhe programi: 725930 00) dhe
- Fletpagesë në vlerë prej 50,00 denarë (Qëllimi i pagesës: Pagesë për taksa administrative, Emërtim dhe seli e pranuesit: Llogaria trezore, Banka e pranuesit: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, Llogaria Trezore:100000000063095, Llogaria: 840 ___ (në varësi të komunës) 03161, Kodin e të ardhurave dhe programi: 722313 00).

Dokumentacioni i lartpërmendur dorëzohet në origjinal ose kopje.

Nëse dokumentacioni dorëzohet kopje, besueshmërinë e e dokumentacionit aplikuesi i kërkesës e vërteton me nënshkrim dhe vulë të vetën në secilën faqe të kërkesës.

Kërkesat për subvencionim i shqyrton Komisioni i formuar nga Ministri i Ekonomisë.

Zgjedhja e aplikuesve të cilët i plotësojnë kushtet të parapara me Thirrjen publike do të bëhet në bazë të parimit „**I pari vjen i pari shërbehet**”, respektivisht sipas dorëzimit të aplikacionit, deri në harxhimin e mjeteve në dispozicion.

Në rast se kërkesa e dorëzuar është jokomplete, Komisioni do të drejtohet me shkrim deri te aplikuesi dhe do të caktojë afat për plotësim të Kërkesës për subvencionim.

Me qëllim të ruajtjes së principit „**I pari vjen i pari shërbehet**”, për Kërkesat me dokumentacion jokomplet, si datë të dorëzimit të Kërkesës do të llogaritet data e plotësimit të fundit të Kërkesës, përkatësisht data kur Kërkesa për subvencionim do të jetë plotësisht e kompletuar.

Një aplikues mund të shfrytëzojë subvencione vetëm një herë në këtë thirrje publike.

Pas harxhimit të mjeteve në dispozicion Ministria e ekonomisë do të shpallë Njoftim në www.ecoomy.gov.mk dhe në www.konkurentnost.mk.

Thirrja publike është shpallur në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë www.ecoomy.gov.mk dhe në www.konkurentnost.mk

Kërkesat me dokumentacion të kompletuar dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Ekonomisë, rr. „Jurij Gagarin” nr. 15, Shkup, deri më 29.09.2017.

Kont. tel: (02) 3093 431; 3093 508; 3093 445 www.economy.gov.mk.

